Fig.7.Dimenzionet kryesore në metër, te Thertorës Demi NPT si dhe ndarjet në komora dhe punëtori

Komuna e Mitrovicës gjendet në veri të Kosovës, në një distancë afërsisht 40 km nga Prishtina, me një sipërfaqe prej 326 km katrorë dhe paraqet rreth 3.25 për qind të territorit të Kosovës. Komuna e Mitrovicës numëron 46 vendbanime. Sipërfaqja e tërësishme e komunës së Mitrovicës është e vendosur në të ashtuquajturin bazen i Mitrovicës, në fushën aluviale të lumenjve: Iber, Sitnicë, Lushtë dhe Trepçë, .Lartësia mbidetare e Mitrovicës është 508- 510 m.

Pamja e ngastrës Nr;00265-0 në Zonën Kadastrale në Mitrovicë , është në dokumentacionin shtes në këtë raport të VNM.



Fig. 8. Pozita e Mitrovicës si qytet në raport me Republikën e Kosovës

1.2. Qëllimi i VNM-se

Është:Evidentimi dhe klasifikimi i pasojave negative dhe pozitive të mundshme mjedisore, vlerësimi i faktorëve mjedisor që preken apo që kanë impakt mjedisor dhe përcaktimi i masave preventive zbutëse për minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative të mundshme mjedisore, në veqanti nëse është përqëndrimi ndotës maksimal i lejuar .

Analizimi i operacioneve të punës që do të kryhet gjatë aktivitetit të Objektit Afarist – me objektet përcjellëse dhe vlerësimi i tyre për ndikimet e mundshme mjedisore,

Propozimi i masave për mbrojtjen dhe mirë administrimin e mjedisit, brenda dhe përreth lokacionit dhe objekteve, me synim përmirësimin e vlerave ambientale, mjedisore, estetike dhe Thertoren ““Demi” “ NPTe të tij në rastin konkret për këtë objekt afarist pra: PËRSHKRIMI I OBJEKTIT AFARIST - “THERTOREN E BAGËTIVE TË MËDH E TË VOGËLA DHE PËRPUNIMIN E DHE KONZERVIMIN E MISHIT (1011), ME E=P+0, LOKACIONI LUSHTË NË KOMUNËN E MITROVICËS

Qëllimi i VNM-së është të ofrojë të dhënat bazike në mënyr profesionale për vendim marrësit duke identifikuar efektet potenciale sinjifikative mbi mjedisin dhe ndikimi në mjedis që lidhen me veprimtarinë e lartë cekur si edhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm duke siguruar se veprimtaritë ose projektet e propozuara nuk dëmtojnë burimet e kufizuara, funksionet Thertoren ““Demi” “ NPTe ose mirëqenien, mënyrën e jetesës dhe sigurinë e komunitetit.

Qëllimi i VNM: hartimit të një plani të monitorimit të mjedisit për veprimtarinë e lartë cekur , duke përcaktuar indikatorë të matshëm , duke aplikuar pranë DMMU në kaudër të MMPH-së , sektorin e VNM për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për:

1.3. PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS PARAPRAKE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të Objektit të lartë cekur si projekte në atë zonë, duke marrë parasysh objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit-mjedisit apo ngastrës kudo është realizue projekti dhe të zbatohet veprimtaria në thertoren “DEMI” .

Raporti i VNM ka për qëllim të sigurojë:

- ❖ Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara dhe në vazhdimsi gjatë funksionimit të aktivitetve dhe veprimtaris së lartë cekur duke filluar që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- ❖ Garantimin e një procesi të hapur vendimarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur;
- ❖ Si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

1.4. OBJEKTIVAT E VNM-SE

Objektivat drejtpërdrejtë të VNM-së:

- Siguron që infrastrukturën kompletimin e ISO standarteve janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit;
- Lehtëson informimin e vendimarrësve,

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut dhe mbrojtjen në punë duke siguruar një mjedis të pastër ;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze të mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, pesiazhet e natyres dhe komponentet përberese të ekosistemeve;
- Përmireson aspektet sociale të projektit.

Objekt i raportit të VNM është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Kosovës, të projekteve të propozuara, private apo publike.

Objekti i këtij raportit të Vlerësim Ndikimit në Mjedis-VNM për OBJEKTIN AFARIST THERTOREN ““DEMI” “ NPT- , ME ETAZHITET (P+0); është të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit, si Objekt afarist Thertoren ““Demi” “ NPT. Duke patur për synim ruajtjen e mjedisit .

- Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë, trajtimin e ujërave para se të shkarkohen në recipient apo efluent , si dhe mos shkarkimet në tokë dhe uji të parametrave fiziko kimik ndotës.

Objektivat e Përgjithshme të VNM-së, përmes raportit të VNM janë:

a). Objektivat afatshkurtra

- Njohja dhe analiza e situatës mjedisore të zonës së ndikuar nga projekti-i lartë cekur
- Të sigurojë nëse burimet-lënda e parë përdoren sipas standardeve dhe në mënyrë efektive
- Të identifikojë masa të përshtatshme për reduktimin e efekteve potenciale që mund të kenë impakt mjedisor nga procesi riciklues i mbeturinave
- Të informojë vendimmarrësit në këtë rast MMPH apo Ministrin e Mjedisit dhe të Ifrastrukturës për situatën mjedisore dhe kushtet dhe kriteret e plotsuara të nevojshme për zhvillimin e projektit - përmes raportit të VNM.

b). Objektivat afatgjata

- Të mbrojnë shëndetin e njerëzve për rrethë dhe sigurinë e tyre brenda Objektit të lartë cekur gjatë punës
- Të parandalojë dëme dhe ndryshime të pa riparueshme për mjedisin
- Të ruaj vlerat e burimeve-resurset natyrore , hapësirat natyrore dhe komponentët e ekosistemeve
- Të mënjanojnë efektet negative sociale, duke i monitoruar dhe identifikuar paraprakisht impaktin mjedisor dhe social

Respektimi i Planit të Menaxhimit Mjedisor do të mundësojë në minimizimin ose parandalimin e ndikimit të mundshëm eventual nga Thertorja “Demi” NPT e lartë cekur –në mënyrë direkte apo indirekte në mjedis.

Vlerësimi i Ndikimeve në Mjedis-VNM të shkaktuara nga proceset e përmendura më lartë janë përcaktuar për pritësit në mjedis të këtyre ndikimeve.

- Ekosistemet natyrore, fauna dhe flora,
- Toka në përgjithsi dhe trolli ku zhvillon aktivitet Thertorja “Demi” NPT e lartë cekur apo litosfera -toka ,mbulesa argjilore e ngastrës nr:00265-0
- Hidrologjia në mjedis (ujërat sipërfaqësore tokësore dhe ato ujëra nëntokësore)- Hidrosfera,
- Cilësia e ajrit –Atmosfera ,

- Klima –Kushtet klimaterike dhe meteorologjike Biosfera ,
- Peizazhi,
- Shëndeti publik dhe cilësia e jetës,
- Trashëgimia kulturore, duke i evidentuar nëse do të ketë përmbajtur ndërtimet arkeologjike dhe ato tradicionale, gjatë plotësimit të kërkesave të lartë cekura , atëher hartuesi i këtij raporti të VNM i ka grumbulluar informacionin e domosdoshëm, që përfshin:
- Kërkesat e përdorimit të tokës dhe mënyrat e përdorimit aktual të saj nga zbatimi i projektit;
- Ndërtimin e kompletuar me të gjitha asetet dhe objektet tjera përcjellëse të Afarist Thertorja Demi N.P.T. së lartë cekur dhe instalimet e pajisjeve teknologjike që do të realizohen;
- Proceset teknologjike,
- Shkarkimet në mjedis, si dhe mundësisht sasinë respektive të tyre në kufijt e lejuar ;
- Gjendjen aktuale të mjedisit ku do ushtrohet veprimtaria, si dhe karakteristikat e veçanta të tij, përfshi edhe statusin ligjor të zonës ku synon të ushtrohet veprimtaria;
- Gjendja e infrastrukturës rrugore, elektrike, dhe kanalizimet e ujërave, si dhe nevoja për infrastrukturë të re të projektit nëse kërkohet ndonji riparim.

Në përputhje me obligimet ligjore dhe natyrën dhe përmbajtjen e dokumentit të hartuar, do të organizohet debati me publikun me komunitetin e zonës si dhe të gjitha palët e interesit për këtë veprimtari të lartë cekur , në kuadër të DMMU dhe në përkrahje ligjore të MMPH sektori i VNM si dhe përkrahja e niveleve komunale dhe publikut të rajonit të Mitrovicës .

Njoftimi i publikut do të shpallet në gazeten ditore, në linkun e kuvendin komunal ,si dhe me shpallje që do të vendosën në atë zonë të interesit.

Hartuesi i dokumentit konkretisht te raportiti te VNM , duke marrë parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku, që vlerësohet i vlefshëm, si dhe monitorimin e MMPHI dhe harton relacionin, që shoqëron projekt dokumentin, ku pasqyrohen mbajtëjen e debatit dhe interesimin e publikut,

Relacioni i përcillet organit vendimmarrës, në këtë rast përmes përfaqësuesve të Ministris së Mjedisit që do të jenë prezent gjatë debatit publik dhe nga prezntimi publik i raportiti të VNM nga hartuesi i raportititë VNM nga N.SH. Gjeomjedisi së bashku me projektin përfundimtar të dokumentit e me procesverbalin e debatit me publikun.

Jane dhene ne menyrt te detajuar gjatë përshkrimit të procesit teknologjik , kurse Objektivat e projektit jane marre ne suaz te Qellimit te projektit.

Metoda e tillë është metoda e mirënjohur e që është e zbërthyer më poshtë.

Pra objektivat duhet të jenë:

-Specifike

-Të Matshme

-Të Arritshme

-Reale

-Të përcaktuara në kohë

1.5. FUSHA E ZBATIMIT TE VNM

Hartimi i Vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis në formen fillestare merret ne konsiderim per tu zbatuar për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësis, natyrës apo vend ndodhjes së tyre.

1.6. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS - VNM

1. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis-VNM përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të Raportit të VNM për Thertorën “Demi” N.P.T. e lartë cekur si pjesë e projektit.
2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis -VNM të Objektivit të Afarist Thertorja Demi N.P.T. së lartë cekur .
3. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis-VNM përfshin përgatitjen, zbatimin funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin, pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.
4. Vlerësimi i projektit përmes raportit të VNM përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

2.0. DISA TË DHENA LIDHUR ME KOMUNËN E MITROVICËS

Mitrovica është njëra prej vendbanimeve më të vjetra të njohura në Kosovë. Pozita strategjike dhe gjeografike në mes dy lumenjve të rëndësishëm, Iberit e Sitnicës, si dhe lumit Lushta dhe Lumit të Stan tërgut motivet ekonomike kanë bërë që territori i Mitrovicës të jetë atraktiv qysh në parahistori. Prej kohës antike deri në mesjetë njihej si Albanik (Monte Argentarum), vend i pasur me argjend e plumb. Zhvillim të hovshëm Mitrovica përjetoi në shekullin e XIX-të, pasi u zbuluan burime të mineraleve dhe xeheve, përderisa më vonë u shëndrrua në qytetin më të zhvilluar industrial në Kosovë. Komuna e Mitrovicës gjendet në veri të Kosovës, në një distancë afërsisht 40 km nga Prishtina, me një sipërfaqe prej 326 km katrorë dhe paraqet rreth 3.25 %për qind të territorit të Kosovës. Komuna e Mitrovicës numëron 46 vendbanime. Sipërfaqja e tërësishme e komunës së Mitrovicës është e vendosur në të ashtuquajturin bazen i Mitrovicës, në fushën aluviale të lumenjve: Iber, Sitnicë, Lushët dhe Trepçë, në shpatijet masive të maleve që përben pjesën veriore të Kosovës me sipërfaqe prej 326 km². Largësia nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina është 38 km. Numrat e fundit të popullsisë në Mitrovicë, janë të përafërta nga institucione të ndryshme. Vlerësimin e 85.000 banorëve të Komunës së Mitrovicës është shumë i përafërt.

Shtrihet në 42.53 shkallë të gjerësisë gjeografike veriore dhe në atë 25.52 shkallë të gjersisë lindore. Lartësia mbidetare e Mitrovicës është 508- 510 m.




Fig.9. Pozicioni i Mitrovicës në krahasim me territorin e Republikës së Kosovës dhe me zonat ndarëse të qytetit të Mitrovicës , pa u përfshirë rajoni i gjerë i Komunës së Mitrovicës .

2.1. LOKACIONIN PËR TË CILIN ËSHTË HARTUAR RAPORTI I FILLESATR I VNM

Lokacionin për të cilin është hartuar raporti i fillestar i VNM për: OBJEKTIT AFARIST THERTOREN ““DEMI” “ NPT- ,” ME ETAZHITET (P+0), e evidentuar sipas zonës Kadastrale Lushtë në Mitrovicës , pronë private në ngastrën 00265-0.

Komuna e Mitrovicës është njësi administrative në pjesën Veriore të Kosovës. Mitrovica ka një shumëllojshmëri të tokave që ndryshojnë sipas përbërjes së tyre pedologjike, fizike dhe karakteristikave kimike. Harta pedologjike e Mitrovicës paraqet një mozaik të vërtetë. Llojet e tokës që gjendet kryesisht në Mitrovicë janë humus, humus silikat, gri acid, toka e kuqe, aluviale dhe depozitimeve sedimentare të tokës dhe një pjesë nga tufitet dhe vullkaniket në lagjën Bair. Ato janë të karakterizuara nga cilësi e tyre mjaft heterogjene. Dominimi i shkrifët (76%) tregon cilësi e tyre të favorshme.


Qyteti i Mitrovicës me Trepçën si industri ishte deri në vitin 2000, një nga qytetet më të ndotura në Kosovë. Sipas Planit të Veprimit Mjedisor të Kosovës, përqendrime të larta të plumbit janë gjetur në tokë në Mitrovicë (57-720 mg / Kg) krahasuar me 450 mg / kg të pranueshme).

Lokacioni është ku është ndërtuar: Objektin afarist Thertoren “Demi” NPT- ME ETAZHITET (P+0),

Në ngastrën Nr;00265-0, nuk i takon ndotjeve të lartë cekura .

Kompleksit industrial “Trepça” gjendet përtej lumit Sitnicë në afërsi të zonës, e cila në të kaluarën gjatë procesit prodhues ka emituar pluhur të metaleve të rënda siç janë: Pb, Zn, Cd, As, Ag, pluhur të squfurit, karbonate të ndryshme etj.

Fig.10. Pozita në raport me planin urban, si dhe pamja e ngastrës 00265-0, në krahasim me zonën e lirë Ekonomike që është rrethë 2.5 km .



. Në territorin e qytetit të Mitrovicës kalojnë 4 lumenj (Ibri, Sitnica, Trepça dhe Lushta). Qyteti i Mitrovicës furnizohet me ujë të pijshëm nga Liqeni i Gazivodës-Ujëmani . Të gjitha ujërat e zeza të qytetit të Mitrovicës dhe vendbanimeve përreth lumenjve të cekur derdhen lirshëm në lumenj pa kurfar trajtim paraprak. Kontaminimi i dheut me metale të rënda të Mitrovicës me rrethinë daton që nga kohërat e lashta. Edhe pas mbylljes së Kombinatit “Trepça”, pjesë të mbetjeve toksike të plumbit-Pb dhe metaleve tjeratë rënda toksike ende janë prezente afër parkut të Biznesit dhe shtrihen deri në deponinë në Zveçan . Ky emision i ndotjes vjen nga shtresimi i këtyre elementeve në sipërfaqën e tokës kur është zhvilluar veprimtaria e lartë cekur gjatë përpunimit të xeheve, dhe kur ishin në funksion shkretorja e plumbit , kurse nga viti 2000 , tani qyteti i Mitrovicës është duke i plotsuar kriteret mjedisore e ambientale , përveq mbetjeve që janë mbetur në disa ngastra dhe hapsira ku kanë qenë veprimtaritë e tilla pra mund të jenë deri në thellësi të tokës në 50 cm dhe nga deponitë e mbeturinave industriale. Pranë brigjeve të lumit Sitnica gjendet deponia e fosfogipsit prej 250.000 ton me përbërje kimike të oksidit të fosforit, oksidit të sulfurit, oksidit të kalciumit, kompozimeve të fluorit dhe oksidet e elementeve alkaline.

Për historikun e Mitrovicës në këtë raport të VNM për të aplikuar për Pëlqimit Mjedisor në MMPHI tani në nuk e shohim të arsyeshëm të e detajizojmë me tepër historikun e Qytetit me rrethinë pastaj edhe anën demografike gjeografike , sociale, ekonomike, kulturore etj .

Në përgjithësi raporti i VNM për OBJEKTIN AFARIST THERTORËN ““DEMI” “ NPT- ,” ME ETAZHITET (P+0); për ngastrën nr:00265-0, vlersojmë se nuk do të emitojë ndotje akustike e as emitim ndotës në ajër, dhe uji gjegjësisht në atmosferë, biosferë , hidrosferë dhe litosferë.

Me infrastrukturë të arsyeshme në fazën fillestare pasi që mbrenda këtij lokacioni gjendet edhe ujësjellësi nga sistemi publik i furnizimit me ujë , mirpo afër po ashtu janë edhe ujërat të destinuara (ujëra industriale sipas infrastrukturës para viti 2000 për Objektet që e përdorin ujërat e që mund të përdoret edhe për nevojat teknike të mundshme>

Objekti është mjaft i madh për kapacitetin e vogël të prodhimit të mishit përmes Thertorës Demi NPT , në fund të Oborrit Ekonomik është e konstruktuar Gropa septike me dimensione përkatëse sipas Kapacitetit të Thertorës së lartë cekur.

Objekti afarist Thertoren ““Demi” “ NPT- ,” me etazhitet (p+0),

I plotëson kriteret e infrastruktures në të cilën përfshihen akumulimi i prurjeve të ujërave nga te reshurat atmosferike dhe trajtimi i tyre para se të shkarkohen në recipient, nuk ka shkarkime tjera në tok, ajr dhe uji.

2.2. PARIMET E HARTIMIT TE VNM-SË DHE ELEMENTET KRYESORE STRATEGJIKE TE MBROJTJES SE MJEDISIT

Parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit , ku mbështetet edhe ky raport VNM-je janë :

- a). Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;
- b). Parimi i kujdesit dhe mbrojtjes së shëndetit;
- c). Parimi i parandalimit të ndotjes së mjedisit krahas zhvillimit ekonomik ;
- ç). Parimi "ndotësi paguan";
- d). Parimi i riparimit të dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit të mjedisit të dëmtuar;
- dh). Parimi i përgjegjësisë ligjore;
- e) . Parimi i mbrojtjes në shkallë të lartë;
- f). Parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit në politikat sektoriale;
- g). Parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore;
- h). Parimi i transparencës në vendimmarrjen mjedisore.

"Zhvillimi i qëndrueshëm" i cili është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe të ardhmes prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre".

"Përdorimi i qëndrueshëm " i burimeve natyrore e minerare i cili siguron plotësimin e nevojave të sotme, pa cenuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto burime".

"Teknikat me të mira të mundshme" përfaqësojnë fazën me të përparuar dhe me nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, të zhvillimit të një veprimtarie dhe që janë plotësisht të zbatueshme nga pikëpamja praktike dhe ekonomike".

"Parimi i parandalimit" është përzgjedhja dhe miratimi i variantit më të mirë, që në fazën fillestare të vendimmarrjes, për të shmangur ndikime të dëmshme të një veprimtarie në mjedis".

"Parimi i riaftësimit" është domosdoshmëria për të riparuar dëmet mjedisore të shkaktuara nga vete personat fizike e juridike dhe për të përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar".

"Parimi -Ndotësi paguan"" nënkupton koston që paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme. Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, të konsumit të mallrave dhe të shërbimeve që shkaktojnë ndotjen".

Elementet kryesore strategjike të mbrojtjes së mjedisit që janë gjithashtu detyruesisht të zbatueshme edhe për që zhvillon aktivitetin e saj, të përshkruar në këtë raport VNM -je janë:

- Parandalimi dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike sipas bazës natyrore, biogeografike të vendit;
- Riaftësimi i zonave të dëmtuara dhe të ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukuritë natyrore shkatërruese;
- Ruajtja e ekuilibrit të mjedisit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës. Gjate vënies në punë të veprimtarive dhe

instalimeve, personat fizike e juridike sigurojnë:
Zbatimin e te gjitha masave qe parandalojnë shkarkimet mbi norme dhe ndotjen e mjedisit në: tokë, uji, dhe ajr nga Operatori Ekonomik: Objekti i lartë cekur.

Shmangien dhe pakësimin e mbetjeve dhe, aty ku përdorimi i tyre nuk është i mundur teknikisht ose ekonomikisht, neutralizimin e tyre, duke shmangur dhe pakësuar ndikimin ne mjedis;

- Parandalimin e aksidenteve industriale dhe kufizimin e pasojave te tyre;
- Kthimin e vendit ne kushte te kënaqshme mjedisore pas përfundimit te veprimtarisë;
- Njoftimin për çdo ndryshim te planifikuar te linjës teknologjike;
- Respektimin e kërkesave dhe te kushteve te lejes mjedisore;
- Njoftimin e agjencive rajonale te mjedisit, jo më rrallë se një herë në 3 muaj, për rezultatet e vetë monitorimit dhe në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis nëse eventualisht ndodhin ;
- Plotësimin e kërkesave të Inspektoratit të Mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së tyre;
- Njohjen e publikut me gjendjen e mjedisit dhe profilin mjedisor të veprimtarisë;
- Mbajtjen e regjistrave për shkarkimet në mjedis gjatë përdorimin e ujit dhe te energjisë, si dhe për teknikat e përdorura.

. INFRASTRUKTURA LIGJORE DHE ADMINISTRATIVE(PËRSHKRIMI I METODAVE PARASHIKUESE TË PËRDORURA PËR TË VLERSUAR NDIKIMET NË MJEDIS NGA VEPRIMTARIJA E OBJEKTIT TË LARTË CEKUR)

3.0. LEGJISLACIONI PER MBROJTJEN E MJEDISIT- POLITIKA MJEDISORE

Vendi ynë është anëtare dhe pretendent për tu anëtarësuar të një numri konventash ndërkombëtare, si rrjedhojë është e detyruar te zbatoj një sistem sa me efektiv në fushat ekonomik-social-mjedisor, për rregullimin e territorit sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore.

Hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është realizuar duke përfillur dokumentet

Politikat mjedisore e dhe infrastrukturën ligjore të MMPHI sektori i VNM në kuadër të Republikës së Kosovës:

Politikat mjedisore të Bashkësis Evropiane-BE:

- Politikat e Komunës së Mitrovicës –Plani lokal i veprimti në mjedis për zhvillimin ekonomik të zonës ku është lejuar ndërtimi i Operatorit prodhues ekonomik në: Objektin e Afarist Thertorja Demi N.P.T. së larët cekur në ngastrën 00265-0; fshatin Lushtë -K. Mitrovicë .

3.1. BAZA LIGJORE PER HARMONIZIMIN E KRITEREVE PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Ndërgjegjësimi ne Kosove është i një niveli relativisht te ulet, kjo si rrjedhoje e një legjislacioni mjedisor relativisht te ri qe është ne zhvillim dhe në implementim dhe po plotësohet me tej sidomos me rregullore, udhëzime administrative dhe standarde.

Baza ligjore -

bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë, porse dhe parimet dhe konventat ndërkombëtare lidhur me shumë çështje sfiduese. Aplikimet për VNM kane si detyrim paketën ligjore te mëposhtme:

Ligji për VNM NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS; Data e publikimit: 06.01.2023).

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtënëuar për nevojat e hartimit të këtij raport janë shfrytëzuar edhe rregullativat relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis.

- Ligji për VNM NR. 08/L-181 ; Data e publikimit: 06.01.2023.

- Ligji Nr. 02/L-102; 2007 10 Gusht 2011 -Ligjin për mbrojtjen nga zhurma
- Ligji Nr. 03/L-025; 2009 10 Gusht 2011 -Ligji për mbrojtjen e mjedisit
- -Ligji i Ujërave 04/L-147
- Ligji i Inspektoriatit të MMPH-së 04/L-175.
- Ligji 04/L-060; Ligji për mbeturina i harmonizuar me direktivat e BE, për të i sjellur standartet Evropiane në Kosovës, për miratimin e ligjit për mbeturina miratohen udhëzimet administrative -(UA) si në vijim:

1. U.A. Nr: 29/2014; për menaxhimin e llumrave përmes trajtimit të ujërave të ndotura .
2. U.A. ,Nr: 20/2014 ; për menaxhimin e mbeturinave të biodegradueshme;
 - Udhëzimi administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet ne trup ujorë dhe ne rrjetin e kanalizimit publik
 - Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave (
 - b) dokumentacioni teknik
 - Projekti i ndërtimit
 - Çertifikata e regjistrimit të biznesit
 - Çertifikata mbi të drejtat e pronës
 - Kopja e planit të gastrës

3.2. KUADRI LIGJOR EVROPIAN

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqsë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- Rregullativa ligjore
- Legjislacioni ne lidhje me ruajtjen e mjedisit është pothuajse ne përputhje me normativat evropiane te mbrojtjes se mjedisit .
- Ne mbështetje të nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 është hartuar udhëzimin administrative për aplikim ne MMPHI ku qëllimi i tij është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative të projekteve të propozuara, publike dhe private.

Ky Udhëzim Administrativ përcakton rregullat e procedurave për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe për procedurat shoqëruese administrative, gjatë procesit të vendim marrjes nga ana e MMPHI për pëlqim mjedisor, dhe siguron që të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin e që janë ofruar dhe janë marrë parasysh.

- Gjithashtu janë konsultuar edhe udhëzimet administrative ne fuqi te ligjeve te lartcekura.

- Dokumentacioni teknik . Gjatë hartimit të raportit për VNM, përpos eksperiencës profesionale në udhëheqjen këtij procesi janë shfrytëzuar edhe këto dokumente:
- Certifikata e biznesit.
- Fleta poseduese.
- Kopja e planit të parcelës.
 - Plani i situacionit
 - Pëlqimi nga kuvendi komunal i Mitrovicës konkretisht nga drejtorija e mjedisit dhe infrastrukturës dhe drejtorija Inspektoratit sanitar e Komunës së Mitrovicës.
 - Pëlqimet nga drejtorija gjeodete kadastrale e komunës së Mitrovicës, si dhe të gjitha dokumentacionet relevante që janë të shtojc të këtij raporti të VNM.

Duke pas parasysh se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore në kuadër të dokumenteve të lartcekura për nevojat e hartimit të këtij raporti janë shfrytëzuar edhe direktiva relevante ndërkombëtare.

Me poshtë janë paraqitur analiza veç e veç për secilin faktor mjedisor.

4.0. VLERËSIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NE MJEDIS NGA VEPRIMTARIJA E AFARIST THERTORJA DEMI N.P.T. PËR “DEMI”NPT E MBETURINAVE URBANE

Krahas parashikimeve themelore nga rregullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-s për rastin konkret janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke u nis nga fakti se një pjesë e madhe e mardhënjeve specifike nga lëmia e mjedisit nuk është përfshirë në rregullativat ligjore të tanishme prandaj për nevoja të hartimit të këtij raporti të VNM-s është shfrytëzuar përvoja e mirë dhe rregullat relevante ndërkombëtare, si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-s (85/337/EEC).

4.1. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për kompleksin e objekteve gjatë fazës së aktiviteteve në thertoren për therjen e bagëtive të mëdha , bagëtive të imëta dhe objektin përpunimin e mishit të freskët, bëhet në disa faza edhe atë:

- a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë:
 - burimet themelore të ndikimeve në mjedis
 - popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
 - karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është ndërtuar thertorja për therjen e bagëtive të mëdha e të imëta dhe përpunimit të mishit të freskët.
 - klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
 - kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
 - bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar
- b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve
 - madhësia dhe lloji i ndotjes
 - karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
 - gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
 - vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse
- c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin

ku është ndërtuar thertorja për therjen e bagëtive të mëdha, bagëtive të imëta dhe përpunimit të mishit të freskët. Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit.

4.2. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyç të hulumtimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku gjendet Objekti afarist të thertores për therjen e bagëtive të mëdha, bagëtive të imëta dhe përpunimit të mishit të freskët, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna. Çdonjëra nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësisë së mbrojtjes së mjedisit.

Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën nr.10.




Fig.110. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike

Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1. është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristika funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit të thertores dhe përpunimit të mishit të freskët, në hapësirën konkrete.

5.0. PËRSHKRIMI NË ASPEKTIN MJEDISOR PËR TË CILAT EKZISTON MUNDËSIA E NDIKIMEVE TË THEKSUARA NEGATIVE NGA & THERTORJA “DEMI”

Objektin afarist Thertoren ““Demi” “ NPT- në ngastrën:00265-0, fshati Lushtë. Në përgjithësi impakti mjedisor është shumë i vogël i përshkruar edhe më lartë dhe mund të menaxhohet, përshkrimi i masave preventive janë të planifikuar . Përderisa shkarkimet e ujërave , pas pastrimit të Objektit të lartë cekur , do të trajtohen fillimisht para se të shkarkohen në kanalizimin publik, apo edhe në kanalizimin lokal që disa raste organizohet në periferi të qytetit apo në fshatra të komunës së Mitrovicës , nga Objekti i lartë cekur para se të shkarkohen ujërat trajtohen deri në shëndrrimin e tyre si ujëra më ndotje të vogël apo ujëra neutrale ujëra jo të ndotura . Nëpërmjet zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas standardeve ndërkombetare dhe të bashkimit Evropian -BE do të përmbushen dhe plotësohen kërkesat e klientëve, produkteve,

5.1. KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE, KLIMATERIKE, HIDROGJEOLOGJIKE, METEOROLOGJIKE ,PEDOLOGJIKE DHE SEIZMIKE TË TERRENIT NË MITROVICË

Ndikimet gjatë veprimtarive të Operatorëve afarist Thertoren ““Demi” “ NPT: Zona Kadastrale Lushtë në rajonin e Mitrovicës në zonën bair konkretisht në ngastrën nr;00265-0 - në thelb nuk ka ndikime mbi florën dhe faunën që janë në periferi të qytetit në përgjithësi . Për gjatë rrjedhës së lumit të Lushtës dhe që është në një distancë rrethë 3000m . ekzistojnë kushte për jetën e në zonën neritike pranë bregut të lumit Lushtë dhe po ashtu i tërë haspira për rrethë nga lëvizja e lumit , ka bonitet të tokave për rrethë sasi të ujërave nëntokësor. Pra Objekti i Afarist Thertorja Demi N.P.T. së lartë cekur nuk ka ndikim në bonitetin e tokës për rrethë . Si konkludim nga Thertorja “Demi” NPT Zona Kadastrale Lushtë nuk do të ketë ndikim negativ në mjedis : në bonitetin e tokë, florës e faunës ndotëjen e ajrit dhe në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore .

5.2. GJEOLOGJIA DHE HIDROGJEOLOGJIA

Mitrovica ka një shumëllojshmëri të tokave që ndryshojnë sipas përbërjes së tyre pedologjike, fizike dhe karakteristikave kimike. Harta pedologjike e Mitrovicës paraqet një mozaik të vërtetë. Llojet e tokës që gjenden kryesisht në Mitrovicë janë humus, humus silikat, gri acid, toka e kuqe, aluviale dhe tokës me bonitet të lartë pranë lumit të Sitnicës, që përbehet nga depozitimet argjilore me granulacion më të imët.. Ato janë të karakterizuara me cilësi të tyre mjaft heterogjene. Dominimi i shkëmbit (76%) tregon cilësi të favorshme. Cilësi mesatare: rërë fine 51%, baltë -argjilë me lagështi 30%, argjila me lagështi dhe me madhësi granulometrike të rërës balta 10%, dhe rërë të trashë 9%. Ka disa fragmente të ashpra (4%). Në sipërfaqe këto toka përmbajnë një mesatare prej 2% humus.

Konkretisht në aspektin Gjeologjik të ngastrës numër 00265-0, Zona Kadastrale Lushtë mund të themi se përfaqësohet me formacionet argjilore me nuanca në të murrëm e quajtur tokë e zezë Osmonice që gjithësesi e ka bonitet mirpo punimi apo rikultivimi i kulturave bujqesore gjithnjë kërkon kushtet optimale

Kurse në aspektin Hidrogeologjik ky rajon është pranë ujërave apo pranë lumit të Lushtës i cili pastaj shkarkohet në Lumin Iber se bashku me Lumin (kolektorin) e Ujërave të T.C. Kosova -AB dhe ujërave urbane të rajonit të Prishtinës dhe Vushtrris Sipas Planit të Veprimit Mjedisor të Kosovës, përqendrimet të larta të plumbit janë gjetur në tokë në Mitrovicë (57-720 mg /kg) krahasuar me 450 mg /kg të pranueshme).

Regjioni ku është duke vepruar (Objekti afarist Thertorja Demi N.P.T

5.3. KARAKTERISTIKAT KLIMATERIKE

Në përgjithësi mund të thuhet se territori i Mitrovicës është e karakterizuar nga një klimë me diell, temperatura të ndryshueshme dhe lagështi. Lugina e Mitrovicës i takon zonave tërëse të vendit. Bazuar në kushtet klimatike, Kosova mund të ndahet në tre zona klimatike. Rajonin e Mitrovicës i takon zonës klimatike, e cila përfshin zonën e Iberit dhe është ndikuar nga masa ajrore kontinentale. Për këtë arsye, në këtë pjesë të vendit, **dimrat janë:** të ftohtë me temperatura mesatare mbi -3 ° C, por nganjëherë deri në -20 ° C.

Verërat janë: shumë të nxehtë me temperatura mesatare prej 20 ° C, ndonjëherë deri në 37 ° C. Kjo zonë është e karakterizuar nga një klimë të thatë dhe me reshje vjetore totale prej 600 mm në vit, përafërsisht.

Relievi- Kategorisë së relievit kodrinor dhe malor i takojnë pjesa më e madhe e sipërfaqes, sidomos treva e Shalës së Bajgores, prandaj komuna e Mitrovicës me rrethin është trevë më tepër malore se sa fushore. Pamja morfologjike e tanishme i ka paraprirë lëvizjet tektonike që ndodhën në kohën e terciarit – Tc ,kur mbi shtresat gëlqerore janë formuar shtresa të trasha të shkëmbinjve vullkanikë, të cilët si rezultat i proceseve vullkanike janë bartëse të xehes së plumbit-Pb e të zinkut-Zn. Në pikëpamje gjeologjike dhe morfologjike territori i rrethinës së Mitrovicës bënë pjesë në sistemin Dinarik, kurse në aspektin gjeotektonik dhe Gjeomorfologjike dhe si rezultat i lëvizjeve hercinide dhe Alpideve ,Mitrovica i përket Zonës së Vardarit .

Temperatura -Vlerat mesatare të temperaturave dimërore sillen rreth 0 ° C gradë celsius; temperaturat mesatare të pranverës janë 14 ° C gradë celsius, verës 20 ° C gradë celsius ndërsa të vjeshtës 11 ° C gradë celsius.

Lagështia e Ajrit - vlera mesatare e lagështisë së ajrit është 77%, veçori kjo e viseve malore, me maksimum në muajin dhjetor në 85,7% dhe minimum në muajin gusht me 60,5%.

Vranësirat - Vlerat e vranësirës janë variabile për shkak të karakteristikave të ndryshimeve të temperaturave të ajrit si dhe nga heterogjeniteti i maleve të kësaj treve. Viset malore kanë më tepër vranësira, ndërsa pjesa e rrafshët dhe vetë qyteti kanë rreth 45 % të kohës vranësira. Është shënuar se në Mitrovicë mesatarisht gjatë vitit kemi deri 20,5 ditë me mjegull

Reshjet

Sasia e reshjeve në komunën e Mitrovicës është variabile. Kemi reshje mesatare vjetore prej 600 mm për vendet me lartësi të vogël dhe deri në 1,100 mm, ku reshjet më të mëdha janë në stinën pranverës dhe vjeshtë e dimër . Mesatarisht në Mitrovicë kemi stinën e dimrit me borë .

Erërat - Mitrovica mesatarisht gjatë vitit ka 50 - 60 ditë me erëra. Zakonisht erërat që frekuentojnë në Mitrovicën janë erërat e kuadrateve veriore, përkundër faktit që nga ana veriore ka si mburojë malet, këto erëra depërtojnë kryesisht përmes grykës së Ibrit. Prej erërave dominojnë erërat veri-perëndimore. Territorin e komunës e përshkojnë edhe erërat jugore, juglindore dhe jugperëndimore.

5.4. KUALITETI I AJRIT, UJIT DHE TOKËS

Kualiteti i ajrit: S Finalizimi i programit lokal për mbrojtjen e ajrit, përcaktimi i strategjisë për mbrojtjen e ajrit dhe menaxhimi i kualitetit të ajrit brenda komunës ka qenë një prej detyrave kryesore. Monitorimi i kualitetit të ajrit nëVlerat e pluhurit total të ekspozuar gjatë tërë vitit 2012 kanë treguar ndotje më të vogël se vlera mesatare 300/mg/m² ditë. Vlerat mesatare të pluhurit të depozituar silleshin prej 100-300 mg/m² për ditë. Sot baseni ajror i komunës është në gjendje më të volitshme sa

i përket cilësisë së ajrit. Burimet kryesore të ndotjes së ajrit, në shekullin e kaluar ishin: stabilimentet për prodhimin e plumbit, zinkut të kombinatit ‘Trepça’ , kurse nga viti 2000 e tani e tutje janë të mbyllura. Për arsye të ndotjes të pa menaxhuar dhe toksike . Tani ndotja e ajrit nga deponit e mbetjeve industriale mbetet sfidë për të gjithë mirpo në përgjithësi menaxhohet . Efektet e mundshme në cilësinë e ajrit dhe ndërveprimet të lidhura për projektin do të jenë të vogla.

Primare e cilësisë së ajrit dhe shqetësim gjatë veprimtaris tani është ndikimi i grimcave pluhurit , gazrave të cilat lirohen nga trafiku në rrugët .

Kualiteti i tokës : Tani fokusohemi kryesisht në ngastrën nr:00265-0 në zonën kadastrale të Mitrovicës si pjesë e zonës bair, mund të konstatojmë e përveq hapsirës që është e zene tani me Objekte Afarist Thertorja Demi N.P.T. ;nuk ka ndikim ndotës në tokë , kurse parku industrial është me një distanc afro 1.5 km nga Thertorja “Demi” NPT e lartë cekur. Gjatë aktiviteve të ndërtimit nuk janë mbetur inertet e ndërtimtaris si mbeturina , dhe tani është e ndërtuar një infrastruktur funksionale përmes së cilës mbrohet edhe ngastrat tjera dhe tokës për rrethë dhe mbrojtja e ujërave nëntoksore nga shkarkimet e pa kontrolluara jashtë kanalizimit të sistemit publik të kanalizimit qytetit .

Vlerat mesatare të pH varësisht nga muaji silleshin prej 6,15-6,54 në krahasim me vlerën e lejuar të pH =7

Kualiteti i ujit

Uji për pije vjen nga Liqeni i Gazivodës - lumi Ibër që ka cilësi të mirë të ujit. Kapaciteti i ujit nuk mund të shkaktojë probleme furnizuese në objektin e Qumështores “aldi” Frasher në Mitrovicë.

Lumenjtë e Mitrovicës i takojnë pellgut të Detit të Zi. Shumica e lumenjve karakterizohen me rrjedhje të çrregullt sezonale. Rrjedhjet e lumenjve janë më të larta gjatë dimrit ose në fillim të pranverës.

Parametrat kimike të ujit të lumit Ibër tregojnë se ky ujë i përmbush parametrat e cilësisë së dëshiruar. Substanca toksike inorganike nuk janë, prandaj uji i lumit Ibër mund të përdoret për zonën e biznesit në Mitrovicë dhe zhvillimin e aktiviteteve përcjellëse.

. Mirëpo sipërfaqja e ngastrës së lartë cekur si zonë Bair ku do të kryhen aktivitete mjedisore nuk bënë pjesë në zonat e ndotura. Sipas analizave të bëra, në mostrat e tokës të marra nga lokacioni për qëllim të këtij studimi, nuk është konfirmuar prania e ndotësve. Kurse në ngastrën ku është ndërtuar Thertorja “Demi” NPT objektin afarist dhe “DEMI”NPT e klasifikimin Zona Kadastrale Lushtënga rajoni i Mitrovicës dhe nga Mitrovica . Objektin e Afarist Thertorja Demi N.P.T. së lartë cekur për “DEMI”NPT Zona Kadastrale Lushtë, fillimisht duke i klasifikuar , shtrihet në zona kadastrale të Mitrovicës ngastra nr: 033360 , e menaxhuar në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë e Komunës së Mitrovicës. Fshati Zona Kadastrale Lushtë & K.Mitrovicës . Nga veprimtaria e lartë cekur nuk ka identifikim të ndotejes në tokë ajër dhe uji mbi përqëndrimin maksimal të lejuar.

5.5. KRITERET SEIZMIKE

Faktor i mjedisit fizik është edhe kriteri seizmik, që investitori dhe projektanti i projektit e si domos realizuesi i projektit duhet të e marrë në konsiderim edhe kriteret seizmike sidomos gjatë konstruktimit dhe ndërtimit të Objektit të lartë cekur, qoftë në fortësinë e materialit ndërtimor menyrenë e ankerimit dhe cilësinë e betonit, e mbi të gjitha rritjen e stabilitetit të trollit para se të fillohet ndërtimi i Objektit të lartë cekur.

Seizmiteti i terrenit paraqet parametër me interes në vetë për analizën e ndikimeve të mundshme në fushën studimore të mjedisit. Sipas hartave seizmike, hapësira e gjerë e hulumtuar i takon intensivitetit me periudha të ndryshme reversibile që do të paraqiten në tabelën në vijim.

Intensiteti seizmik i regjionit të hulumtuar të skalës MSK-64	
Periudha kthyes (vjet)	Shkalla e seizmitetit
50	VI dhe VII
100	VII, VIII dhe IX
200	VIII dhe IX
500	VIII dhe IX
1.000	VIII dhe IX
10.000	VIII dhe IX

Figura 12. Paraqitja tabelare e intensitetit seizmik në rajonin e Mitrovicës .

Sipas tabelës në figurën 21 për periudhën kthyes prej 500 viteve, kompleksi përkatës gjendet në zonën e shkallës VIII të skalës MSK-64 të intensitetit seizmik, kështu që koeficienti i seizmitetit duhet zgjedhur me vlerë K6 – 0.05. Konkretisht të dhënat seizmike mikroregionale e këtij lokacioni dallohen me mundësi të dridhjeve të tokës të intensitetit prej 7 e deri në 8 përafërsisht në shkallë të merkalit. Sipas ndërtimit të mbrenshëm gjeotektonik dhe dhe platformes gjeomorfologjike dhe stratigrafike dhe litologjike ndikon drejt për drejt në intensitetin e termeteve, vlenë të theksohet se nga aktiviteti seizmik aktiv janë marrun edhe masta preventive gjatë ndërtimit të Objekteve të reja për të rritur sigurinë dhe qëndrueshmërinë e Objekteve në rast të fatkeqësive natyrore me një koeficient të sigurisë me të lartë se sa në shekullin e kaluar. Lidhur me këto faktorë natyrorë tani e tutje

edhe gurorët dhe ndonji aktivitet që duhet të zhvillohet për shkëputjen e trupave minerare apo edhe gjatë ndertimit të Objekteve në etazhitet me stabile, nuk përdoret eksploziv i që ka efektin e vibrimit ndotjes akustike, rezonances etj. Mirpo përdoret një lloji I eksplozivit me karakteristika tjera që mund të ketë me pak ndikim negativ apo në rastet e veqanta nëse është shumë afër venbanimeve edhe mund të mos I lejohet minimi me eksploziv të fuqishëm për arsye të efekteve negative që I cecum si në lekundje vibrim ndotje akustike etj.

5.6. Flora dhe Fauna

Ndikimi i thertoresh për therjen e bagëtive yte mëdha dhe të vogëla si dele etj. dhe përpunimit të mishit të freskët, në domenin e florës dhe faunës paraqet dukuri që kërkon shqyrtim të kujdeshëm, në kuptim të evidencimit të pasojave të ndryshme të mundshme negative dhe zvogëlimit të tyre brenda kufijve të pranueshëm. Përbërja gjeologjike e tokës kushtet klimatike dhe relievi ndikojnë në zhvillimin e bimësisë. Në këtë pjesë kryesisht dominonë bimësia e tipit klimatik kontinental, pra mbretëron bimësia gjetherënëse. Dominojnë kryesisht bimët barishtore ato të ultë një vjeçare. Karakteristike janë bimët e larta drunore gjethegjera që krijojnë hijezim të plot siç janë: Plepi, Shelgja, etj ketu kemi një oazë me llojllojshmeri të bimësisë si asaj barishtore dhe asaj drunore.

Kryesisht bimët i takojnë tipit kserofit që do të thotë bimë që përshtaten kushteve klimatike me ndërrime stinore. Bimët drunore kanë trup të zhvilluar dhe të trash ku paraqesin një peizazh të bukur.

Në lokacionin ku gjenden objektet e thertoresh për therjen e bagëtive të mëdhasi gjedhit etj dhe të vogël dhe përpunimit të mishit të freskët, gjegjësisht ngastrat nuk ka qenë e mbjellur me të lashta periodike bujqësore, por ekziston si djerrin e mbuluar me barë të egër dhe drunjë mesatar e shkure që shihet në fotot në vijim.

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokacion kemi të bëjmë me hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi.

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, shpezët etj.

Prej brejtësve jetojnë- mijtë, prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm, breshkat e tokës zhapini i gjelbër, insektet krahëfortë, krahëlusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike, bilbilat, thëllënëza e fushës, sorrat etj.

Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mund të rrezikohen me funksionimin e thertoresh për therjen e bagëtive të mëdha si gjedheve e asaj të vogël si deleve dhe përpunimit të mishit të freskët.

5.7. Efektet vizuale (peizazhi)

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin thertorë për therjen e bagëtive të mëdha si gjedheve e asaj të vogël si deleve etj, dhe përpunimit të mishit të freskët –mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike efektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Lokacioni ku është i ndërtuar kompleksi i objekteve të thertoresh për therjen e bagëtive të mëdha si gjedheve, bagëtive të vogëla si dele etj. dhe përpunimit të mishit të freskët, gjendet në një teren të rrafshët të përshtatshëm. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Kompleksi i objekteve të thertoresh me veprimtarinë e lartëcekur dhe përpunimit të mishit të freskët, është

ndërtuar ne lokalitetin që distanca nga objektet banuese është mbi 250 m që do të thotë se ekzistojnë objekte të ndërtuara të më hershme dhe ne efektet vizuale nuk do të ketë ndikime negative se është mësuar shikuesi me këtë gjendje të mjedisit.

5.8. Ajri

Edhe pse ne rrethin të këtij lokacioni deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku gjendet kompleksi i objekteve të thertoresh me veprimtarinë e lartëpermendur. Nga vet konfiguracioni i terrenit dhe prezenca e florës, si dhe mos ekzistimit të objekteve industriale ne afërsi të lokacionit mund të konkludojm se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të mirë. Mirëpo fregvenca e automjeteve në rrugët e qytetit ndikojnë në ndotjen e ajrit,

5.9. Uji

Edhe pse nuk ekzistojn objekte industriale ne afërsi të lokacionit mund të konkludojm se pastërtia e ujit në këtë lokalitet është në nivel mesatar. Ndotja e ujit shkaktohet nga ujërat e zeza të cilat shkarkohen nga komuniteti ne recipient të pa trajtuara si dhe hedhja e mbeturinave nga komiteti ne skajet e brigjeve të lumenjve .

6.0. Përshkrimi i Objekteve të Thertoresh së Gjedheve dhe Përpunimit të Mishit të Freskët

Ne bazë të projektit të ndërtimit janë të përcaktuara madhësia, pozita të cilat janë të përshkruara ne mënyrë detale dhe të paraqitura ne mënyrë grafike ne situacion për objekte të thertoresh për therjen e bagëtive të mëdha dhe të vogël si gjedheve, etj. dhe përpunimit të mishit të freskët dhe infrastrukturën përcjellëse. Objektet e thertoresh me veprimtarinë e lartëpërmendur duhet ne tersi të i plotësoj kushtet e përcaktuar për mbajtjen e bagëtive të mëdha si gjedheve etj, therjen e tyre dhe përpunimin e mishit të freskët, kushtet dhe rekomandimet që do të jepen ne raportin e Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis, kushtet të përcaktuara ne projektin kryesor për ndërtimin e objekteve të thertoresh me veprimtarinë e lartëcekur. Objektet për mbajtjen e bagëtive të mëdha e të vogël, therjen e tyre dhe përpunimin e mishit të freskët, do të posedoj të gjitha hapësirat e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së lartë shënuar dhe ate: hapësirën (shtallën) për qëndrim të përkohshëm të bagëtive të mëdha e të vogël dhe hapësirën e depos për mbajtje të ushqimit për bagëti të madhe e të vogël hapësirën (linjën) e therjes me pajisjet përcjellëse, hapësirën për përpunimin e mishit së bashku me pajisjet përcjellëse, komorën për ftohje, prodhimin e produkteve tradicionale sips kërkesës së lokaliteti në Mitrovicë si Suxhuk të shtëpis, plesakvica, mishë I bluar, pra këto janë produktet primare ditore qe mundë të I prodhojë Mishtorja Demi N.P.T. apo vetem sugjukun dhe Plesakvicën

mbledhjes së plehut, therjen e tyre dhe përpunimin e mishit të freskët.

Ndërtimi i objekteve të thertoresh me veprimtarinë e lartëcekur ne tersi ka qenë i ndertuar ne ish sistemin me ISO standarde ne bazë Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110, nga të tjerat përcaktohet se materialet ndërtimore mund të përdoren për ndërtime vetëm nëse kualiteti i tyre është ne përputhshmëri me kërkesat e normave teknike standarde.

Për të arritur prodhimtari të dëshiruar dhe kualitative, për pos kushteve të siguruara teknike përpos pajimeve të lartë cekura, si kushte teknike që duhet siguruar janë edhe sistemi i ventilimit, sistemi i aklimatizimit, duhet të sigurohet sasi kualitative dhe e mjaftueshme e ushqimit për kafshët me qëndrim të përkohshëm, do të zbatohet teknologji e avancuar për therjen e kafshëve dhe përpunimit të mishit, angazhimi i fuqisë punëtore është I organizuar sipas kapacitetve të planifikuar që zakonisht mundë të ketë një vazhdimsi të kërkesave për mishë të freskët gjatë sezonës së fesatve, kurse në ditet tjera bije kapaciteti I prodhimit të mishit sepse kërkesat janë më të vogla. Megjithate Thertorja Demi N.P.T. I ka plotsuar të gjitha kriteret për një funksionim sipas ISO standarteve, që fillimisht I ka filluar dhe i ka plotsuar në tërësi gjitha kriteret në nivelin e komunës përkatëse në aspektin e higjienës dhe masta sanitare efikase dhe në nivel sa më të lartë profesional, duhet të aplikohet mbrojtja e mirë shëndetësore e gjedheve e bagëtive tjera dhe të kenë kontroll të rregullt nga mjeku veterinar.

6.1. Përshkrimi i procesit teknologjik

Për kryerjen e procesit teknologjik është siguruar teknologjia e fundit që janë ekspozuar në treg nga materialit inoks e importuar. Për kryerjen e procesit të prodhimit kryesisht janë dy e ndonji herë tre puntorë sepse janë kapacitet e realizuara të vogla sipas kërkesave të tregut . Transport inga dhoma frigorifer apo dhoma përkatëse e ftohtë bëhet deri te mishtorja Demi në qytetë të Mitrovicës

. Transportin kryesisht do të e bën me mjete transportuese kamion deri në objektin e thertores, në thertore do të ekziston : linja e therjes se gjedheve dhe linja e përpunimit të mishit .

Kapacitetet e projektuara të thertores për linjën e therjes së gjedheve do të jenë njëzet mesatarisht deri në tri apo katër gjedhe , apo edhe me kapacitet më të vogël, kurse në ditët festive me kapacitet më të madhë deri njëzet e pesë (100) krerë gjedhe në një ndërrim (ditë), mirëpo therja e gjedheve varet sipas kushteve ne treg dhe rrethanave tjera. Kjo kompani produkt kryesor do të e ketë prodhimin e mishit të freskët me ashtë më afatë të shkurtër dhe afatë të gjatë,

Përveç mishit të freskët kompania do të e bën edhe përpunimin e mishit sipas kërkesave të tregut, do të bën bën prodhimin e këtyre produkteve:1. Suxhuk shtëpiak, 2. Mish i terur-Proshutë, 3.Pleskavicë.




Fig. 13.Skema -Procesi teknologjik i prodhimit të mishit të freskë është i paraqitur në skemën teknologjike

6.2. Qëndrimi përkohëshëm i Gjedhave në objektin përcjellës të Thertorës -Shtalla

-kafshët e planifikuar për therje sipas kontrollimit nga Veterinari

Kompania për prodhim do të e shfrytëzojnë ujin nga ujësjellësi kurse për ujitjen e hapësirave të gjelbëruara larjen platos dhe kopshtit të vogël Brenda oborrit të Thertorës Demi, e përdor ujin e pusit si burim vetanë që është Brenda oborrit të thertorës Demi sepse edhe mundë të mbahet edhe cilësia e ujit në ate pusë. Nëse përdorët uji I tij edhe me sasi të vogël vetëm në stinën e verës.

Bagëtite medha si gjedhet e ato të vogëla vjetat etj. nga tregjet sillen me mjete transportuese në thertore dhe vendosen në shtallën e kompleksit të thertores për qëndrim të përkohshëm.

Në stallë gjedhet vendosen nëpër boxe (hapësira të ndara) brenda shtallës ku atyre u ofrohet ushqim dhe ujë.

Koha e qëndrimit të gjedheve në këto hapësira është e planifikuar sipas planit të prodhimit dhe kërkesave të tregut për mish dhe për produkte të mishit.

7Shtalla duhet të jetë e pajisur me infrastrukturë përcjellëse si uji, higjien largimi I plehrave qdo ditë si dhe rryma. Ashtu që duhet siguruar kushtet maximale për qëndrim të përkohshëm të tyre, gjedhet para se të vendosen në shtall duhet të i nënshtrohen kontrollit Veterinar për identifikimin e ndonjë sëmundje eventuale në gjedhet e importuara, nëse ndodhe që të ketë ndonjë rast i tillë atëherë pasojnë masat preventive për izolimin e rastit.

Gjatë qëndrimit të gjedheve në stallë atyre ju ofrohet ushqimi dhe uji për pije qëndrimi kohor i tyre në stallë varet nga plani i prodhimit gjegjësisht kërkesave të tregut.

6.3. Pushimi i gjedheve

Gjedhet para se të i nënshtrohen procesit të therjes duhet të pushojnë së paku 12 orë në hapësirat e përcaktuara brenda shtallës, gjatë kësaj kohe atyre duhet të i ofrohet ujë për pije, nëse ndodhë që ato të qëndrojnë më shumë se 12 orë atëher duhet të i ofrohet edhe ushqim.

Por duke patur parasysh faktin se në rastin e kompanisë, Demi” N.P.T. nuk kemi të bëjmë me kultivim dhe rritje të gjedheve por vetëm me qëndrim të përkohshëm atëherë qëndrimi i gjedheve në këto hapësira është relativisht i shkurtër.

6.4. Shënimi i gjedheve

Shenjat i vendosen gjedheve ebagëtive tjera të vogëla me qëllim të evidentimit të tyre nëse ndodh që ndonjë gjedhë të jetë i sëmurë atëherë identifikimi të jetë sa më efikas, kështu që ato njëkohësisht janë të nënshtuar kontrollimit veterinar para therjes, p.sh. kafshët që kanë temperaturë të lartë 40 °C konsiderohen se janë të sëmura nga sëmundjet ngjitëse, Prandaj shënimi i kafshëve është për identifikim sa më të shpejt dhe efikas dhe për këtë të mbahet evidence nga veterinari i cili e bën kontrollin gjedheve. Therja nuk lejohet nëse gjedhet janë të smuara nga ndonjë sëmundje ngjitëse paraprakisht e identifikuar si dhe raste tjera që janë të shumtë si (shenjat e lodhjes së tepërt, apo nëse kafshët kanë marr substanca me veprim farmakologjik(antibiotic), e nuk ka kaluar kohe e mjaftueshme për largimin e tyre nga organizmi, nëse kafsha është shëruar me substance hormonale deri në nxjerrjen e tyre nga organizmi),etj. Prandaj kompania, Demi N.P.T.” do të e bën kontrollimin e gjendjes shëndetësore të gjedheve për këtë qëllim dhe me konstatimin e veterenierit se gjendja shëndetësore e gjedheve është e kënaqshme procesi i prodhimit vazhdon më tutje.

6.5. Therja e gjedheve

Therja do të zhvillohet në mënyrë strikte karakteristike e metodës hallall për therje duke e prerë gjedhin në fytë në mënyrë profesionale dhe rutinere duke ja prerë muskulaturën dhe enët kryesore të gjakut. Prerja e gjedheve do të zhvillohet sikur më poshtë. Në rastin konkret të kompanisë,, Demi N.P.T.” do të kemi therjen sipas rregullës së hallallit dhe standartit Haschap të cilën e aplikon kjo kompani gjatë procesit të therjes e cila dallon nga proceset tjera të therjes që si parim e kanë së pari alivanosjen e gjedhit duke ia dëmtuar organet vitale me anë të forcës . Në këtë fazë fillon lirimi i gjakut dhe pastaj vazhdohet me procesin final të liritimit të gjakut duke e ngritur gjedhin në pozitë vertikale me anë të vinçit elektrik.



Foto.4. Pamja e puntoris Demi NPT , gjatë përgatitjes së mishit për treg , njëherit për vendosjen në komoren e ftohtë der isa të dergohet ne shitoren për shitje

6.6. Lirimi i gjakut

Gjedhet e therura vendosen në linjën e lirit të gjakut në pozicion të ngritur lartë me anë të vinçit elektrik me elektromotor, kjo linjë do të posedon mbledhësin e gjakut me kapacitet të mjaftueshëm ashtu që të mos duket gjaku në hapësirat jashtë mbledhësit në afërsi, vetë procesi zgjat rreth pesë minuta, e në rastin konkret do të kemi kapacitete të mjaftueshme të projektuara më parë për këtë qëllim, sasia e gjakut e cila lirohet nga gjedhet është 4-5% e peshës totale të gjedhit. Këtu vlen të përmendet se linja e therjes do të posedon sistemin e akumulimit të gjakut në rezervuare të posaçëm.

6.7. Heqja e lëkurës, kokës dhe organeve të brendshme të gjedhit

Së pari gjedhit i hiqen këmbët, brinjët nga koka etj. dhe pastaj vazhdohet me heqjen e lëkurës. Heqja e lëkurës ose rrjepja është faza shumë e rëndësishme e përpunimit të trupit, ajo pasi të hiqet vendosen në hapësirë të posaçme i nënshtrohet procesit të kryposjes dhe pastaj i dedikohet tregut për shitje. kjo do të thotë se nuk kemi përpunim të mëtutjeshëm të lëkurave. Nga trupi i gjedhit pastaj pason largimi i organeve të brendshme të gjedheve si mëlçia, veshkat, mushkëritë, dhe stomaku me zorrët si dhe organet tjera të brendshme. Pas heqjes së organeve të brendshme pason shpëlarja eventuale e trupit të mishit me ujë nëse është e nevojshme dhe pastaj vazhdon faza e prerjes së trupit. Pjesët e organeve që nuk hahen (brinjët, këmbët, eshtrat etj) vendosen në thasë të plastike dhe do të ruhen në komorë ftohëse dhe pastaj transportohen në deponi të mbeturinave të qytetit.

6.8. Prerja e trupit dhe përpunimi

Në këtë fazë trupi ndahet në mes me anë të sharrës automatike duke e ndarë në dy pjesë dhe pastaj pason shpëlarja eventuale mishit, nëse do të ketë nevojë për shpëlarje, ndonjë pjesë e zhytur nga pakujdesia gjatë procesit të therjes si dhe krejt në fund kontrollimi i mishit nga inspektori përkatës i **veterinës** dhe dërgimi i mishit në **komora ftohëse**.

6.9. Ftohja dhe ngrirja e mishit,

Mishi para nxjerrjes në treg duhet të ftohet prej -0.5-+4 gradë celsius, poashtu edhe organet e gjedhit që hahen duhet të ftohen, prandaj në thertoren, Demi N.P.T.” ekzistojnë hapësira e mjaftueshme komora për ftohje të cilat kanë pajisjet adekuate për kontrollimin e temperaturës të produktit, mishi i ftohur në këtë mënyrë nxirret në treg duke i furnizuar furnitorë të ndryshëm të cilët pastaj e bëjnë shitjen e produkteve me pakicë për konsumatorin, pason Vulosja e mishit përgatitja finale për shitje.

Mishi sipas këkresave të tregut të prodhuar në këtë formë si mish me ashtë shitet në treg kurse pjesa tjetër përpunohet dhe i nënshtrohet procesit të bluarjes dhe në treg del si produkt i tillë. Vetë fakti se kemi në pjesën më të madhe prodhimin e mishit me ashtë sasia e mbeturinave të ngurta prej eshtrave është shumë e vogël. Njëkohësisht këtu duhet të kemi parasysh faktin se edhe sasia yndyrave në ujërat e zeza të procesit teknologjik është shumë e vogël sepse kemi vetëm një të sasisëmë pakë të mishit që i nënshtrohet procesit të matujeshëm të përpunimit –bluarjes.

6.10. Përpunimi i mishit

Skema teknologjike e përpunimit të mishit është paraqitur më poshtë. Kjo fazë e përpunimit nënkupton veprimet të cilat janë saktësisht të përshkruar në tabelën e më poshtme këto veprime kryhen me ndihmën e mjeteve përkatëse për procesim të mishit si thika, mikser, masazher, injektor etj.

Imtësimi dhe përzierja e formimi
Prerja ,imtësimi dhe bluarja e mishit
Përzierja dhe homogjenizimi
Bluarja
Formimi dhe ngjeshja
Procesi i prodhimit të produktit
Kryposja edhe përdorimi i Qepës dhe mëlmesave tjera për suxhukun e shtëpis si një produkt tradicionale i kërkuar në tregun lokal të Mitrovicës dhe injektimi si suxhuk
Proceset e përpunimit termik- Nuk i realizon
Procesi i ftohjes -po
Ftohja
Ngrirja
Operacionet proceseve shitesë – nuk ka

Tabela nr 1. Pamja e përpunimit të mishit për produktet sipas kërkesave të tregut vendor , mishi I bluar, , pastaj faza e dyte produkti I suchuk shtpijak tradicional pa additive vetëm me melmesa natyrore Bio prodhim.

Me imtësim nënkuptohet prerja e mishit në copa të imta, për prerje përdoren pajisje të ndryshme mekanike dhe elektrike. pas prerjes mishi vendoset në **komorën ftohse** dhe mund të shitet i freskët. Përpunimi i mishit ka për qëllim mirëmbajtjen dhe ruajtjen e karakteristikave duke i shtuar komponentë të ndryshme si aditiv melmesa bio natyrore. Me imtësim të mishit dhe përzierje ruhet baraspesha kimike e përbërjes së mishit dhe ekstrahimi i proteinave. prej pajisjeve në këtë pjesë përdoren injektorët, përzierësit, masazherët e ndryshëm etj. Qëndrueshmëria e mishit arrihet me nxemje, zierje dhe pjekje si dhe dehidratimin e prodhimit ashtu që të mund të paketohen dhe deponohen në afat më të gjatë në kushte të caktuara. Teknikat e mirëmbajtjes së kualitetit të produktit siç janë fermentimi, tymosja, kryposja, përdoren kryesisht sipas kërkesës së produktit në treg. Të gjitha këto procese mundësojnë vazhdimin e qëndrueshmërisë së produkteve të mishit dhe me këto procese ngadalësohet rritja e mikroorganizmave të padëshirueshëm. Kryposja me anë të injektimit me shtypje përdoret

për rritjen e afatit të qëndrueshmërisë së mishit. Përbërja e materies për kryposje është uji dhe kripa e kuzhinës ose kripa nitrite, melmesat e ndryshme, aditivet që mundësojnë shije më të mirë të produktit si dhe rritjen e qëndrueshmërisë.

injektohet tretësira me kryp, me shtypje apo qëndrimi I mishit në tretësirën me krip në sasi të caktuar. Pas këtij procesi produktet vendosen në masazher të ndryshëm dhe qëndrojnë një kohë të caktuar. Masazha e mishit bëhet në vakum në temperatur + 4°C. Mishi si lëndë e parë pas procesit të pregaditjes vendoset nëpër kallëpe apo zorrë dhe merr formën e dëshiruar. Më lartë është përshkruar procesi i përpunimit të mishit të freskët kurse për rastin konkret të kompanisë, Demi” për momentin bën prodhimin e mishit me ashtë sasisë dhe vetëm më pakë se gjysma apo deri në 20% përpunimin gjegjësisht bluarjen e mishit . Si produkte tjera që do të prodhohen në thertore janë: Mish i terur-Proshut vetëm nëse ka kërkes të veqant dhe, Suxhuku shtëpiak, Pleskavic, mishë i bluar etj. Gjatë prodhimit të këtyre artikujve si lëndë e parë përdoret edhe krypa e kuzhinës ,natrium nitriti, natrium nitrat, polifosfati, aditiv për qëndrueshmëri , mëlmesa si që janë biberi i zi, biberi i kuq i bluar, sipas recepturave përkatëse, për terjen e suxhukut dhe prodhimeve tjera si lëndë djegëse përdoret kryesisht rryma , në mungesa rryme përdorën edhe gjeneratori për të arritur plotësimin e kriterëve për prodhimin edhe ruajtjen e mishit të freskët për treg .

7.0. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasoj e aktiviteteve që kryhen në kompleksin e objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët, tregojnë se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre . Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis duhet të bëhet për fazë e ndërtimit të objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët, për fazën e realizimit të e aktiviteteve që kryhen në kompleksin e objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët, gjithashtu duhet parapa ndikimet e mundshme në mjedis pas përfundimit të aktiviteteve që kryhen në thertoren për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët.

Me qenëse kompania,, Malësia” synon praktikën përpunuese , prodhuese të mirë dhe synim i saj i ardhshëm është implementimi i standardeve HACPP dhe ISO për këtë lami. HACPP (Hazard Analysis and Critical Control Points) është standard ndërkombëtar i cili bazohet në praktikën e mirë të prodhimit të ushqimit. Standardi HACPP manifestohet në këto parime:

- Identifikimi dhe analiza e rrezikut
- Përcaktimi i pikave kritike kontrolluese
- Përcaktimi i kufijve kritik për të gjitha pikat kritike
- Vendosja e sistemit përcjellës
- Definimi i masave korektuese
- Vendosja e verifikimit
- Vendosja e dokumentacionit dhe përcjellja e evidencës

Prandaj kjo nënkupton se është e nevojshme ndryshimi i politikave mjedisore sipas rregullativës ligjore për mbrojtën e Mjedisit.

Kështu që menaxhimi me mbeturina, përdorimi i sistemeve bashkohore për trajtimin e ujërave teknologjik para shkarkimit, zvogëlimi i shpenzimit të ujit për njësi të produktit, shfrytëzimi racional i energjisë elektrike, hapësirat e gjelbëruara në objekt të gjitha këto janë veprime shumë miqësore me Mjedisin që nënkuptojnë investime shtesë.

7.1.. Ndikimet në ajër

Gjatë fazës së ndërtimit të objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët nuk kemi ndotje të theksuar të ajrit. Ndotja e ajrit ndodhë nga makinat ngarkuese dhe automjetet transportuese, që

nevojitën për gjermimin e kanaleve, bazamenteve dhe transportimin e materialit ndërtimor, ndotja nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese, gjatë realizimit të fazës së ndërtimit, ndotja nga pluhurat që lirohen nga dheu i depozituar dhe bartja e dheut.

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve në kompleksin e objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët ndotje të ajrit mund të ndodh nga aroma e pa këndshme që lirohet nga plehrat të krijuar nga gjedhet, aroma nga therja e gjedheve, ndotje të ajrit mund të ndodh nga gazrat të cilët lirohen nga lëndët djegëse që nevojiten për therjen e suxhukut dhe mishit të terur, dhe ngrohjen e hapësirave të objekteve gjatë stinës së dimrit, e cila ndotje është minimale. Ndotje e ajrit ndodh nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuese të cilat nevojiten për transportimin e gjedheve, automjetet transportuese për transportimin mishit dhe produkteve të tij, automjetet transportuese për transportimin e plehut në gjendje të ngurtë dhe në gjendje të lëngët.

7.2.. Ndikimet në tokë

Gjatë fazës së ndërtimit të objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët ndikim negativ në tokë paraqitet në aspektin e humbjes së sipërfaqes pjellore të tokës, mirëpo duke pasur parasysh vetëm sipërfaqen në të cilën ndërtohet objekti me sipërfaqet manipuluese dhe krahasimin e përfitimit nga kjo sipërfaqe ky ndikim është i pa përfillshëm, ndikim negativ në tokë paraqitet nga deponimi i dheut të gjërmuar për kanal dhe bazamente, si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta komunale të cilat i krijojnë punëtorët. Nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese. Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm, nga mjetet e rënda maqinerike që nevojiten për hapjen e kanaleve, bazamenteve dhe ngarkimin e materialit të gjërmuar, nga mjetet transportuese që transportojnë materialin ndërtimor.

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve në kompleksin e objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët, ndotja e tokës ndodh nga plehrat të krijuar nga gjedhet, nga pjesët e organeve si që janë (brinjët, këmbët, eshtrat, lëkura etj) nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve nga automjetet transportuese të cilat nevojiten për transportimin e ushqimit për gjedhe, nga automjetet transportuese të cilat nevojiten për transportimin e gjedheve, automjetet transportuese për transportimin mishit dhe produkteve të tij, automjetet transportuese për transportimin e plehut në gjendje të ngurtë dhe në gjendje të lëngët, nga mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. Ndotja e tokës ndodh me derdhjen e freonit i cili gjendet në komorën ftohse që nevojitet për ftohjen e mishit.

7.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga mbeturinat e plehrave që krijohen, nga gjaku i cili lirohet nga gjedhet e therura, nga pjesët e organeve që nuk hahen (brinjët, këmbët, eshtrat etj) nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura më lartë me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike, ndotja e ujërave ndodh me larjen dhe dezinfektimin e hapësirave të punës.

Ndotja nga ujërat e procesit teknologjik si që janë ujërat të cilat lirohen nga reparte të ndryshme të kompleksit të thertores si stalla e gjedheve, therja, përpunimi i mishit, nga trajtimi i lëkurave, nga shpëlarja eventuale e mishit, të organeve të brendshme, nga larja e dysHEMEVE dhe mureve të hapësirave punuese në përgjithësi gjatë procesit të prodhimit gjegjësisht të procesimit të mishit, nga derdhja e ujërave të zeza, larja e platos së autoparkingut etj.

7.4. Ndikimet në Peizazh

Duke pasur parasysh pozitën e lokacionit, formën dhe pozitën e vendosjes së objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët si dhe duke pasur parasysh ekzistimin e objekteve tjera banuese, thertorja për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët, nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e

peizazhit në lokacionin e analizuar, prandaj thertorja për therjen e gjedheve dhe përpunimin e mishit të freskët nuk ndikon në shikuesin.

7.5. Ndikimet në botën bimore

Gjatë fazës së ndërtimit të objekteve të thertoresh për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët me infrastrukturë e cila fazë nuk është pjesë e projektit dhe gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të lartëpërmendur në thertoren në sipërfaqet e objekteve dhe hapësirat e parkingut bota bimore tërësisht do të zhduket, e cila në sipërfaqet e degraduara jashtë sipërfaqeve të objektit duhet të mbillet pas përfundimit të fazës së ndërtimit të objekteve të thertoresh për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët.

Nga ajo që u cek më lartë ndërtimi i objekteve të thertoresh me infrastrukturë përcjellëse në këtë lokacion nuk do të ketë ndikime të theksuara në botën bimore. Sipërfaqet e lira të ngastrës për rreth objekteve të thertoresh për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët duhet të mbjellen me bimë (barishte) dhe drunjt dekorativ.

7.5.. Ndikimet në popullatë

Ndërtimi i kompleksit të objekteve të thertoresh me veprimtarinë e lartëcekur në këtë lokalitet pak të zhvilluar ekonomikisht, për pos sigurimit të mishit të freskët për nevojat ushqimore në sasi të mjaftueshme, ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rejonit, për atë se për të zhvilluar aktivitetet prodhuese do të punësohen një numër i konsideruar i punëtorëve. Nga kjo që u tha më lartë objektet e thertoresh për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët për pos ndikimeve pozitive që do të ketë për sigurimin e mishit të freskët për nevojat ushqimore në sasi të mjaftueshme për popullatën, do të ketë edhe ndikime pozitive në aspektin e punësimit.

7.6. . Ndikimet nga Zhurma

Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të thertoresh për therjen e bagëtive të mëdha si gjedheve e asja të vogël si dele etj dhe përpunimit të mishit të freskët, duke pasur parasysh madhësinë e thertoresh si dhe llojin e aktivitetit, zhurma është shumë e vogël dhe nuk ka ndikim të theksuar negativ në mjedis. Prandaj si që u cek më lart aktiviteti i objekteve të thertoresh, në këtë lokalitet nuk do të ketë ndikime negative në aspektin e zhurmës.

7.7.. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Për arsye të natyrës së aktiviteteve objekteve të thertoresh për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët, aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin.

Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë.

Në fazën e kryerjes së aktiviteteve të thertoresh për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët aksidentet mund të ndodhin nga mundësia e shkaktimit të zjarrit, aksidentet mund të ndodhin nga rrjedhjet e lëndës djegëse naftës nga automjetet transportuese, lajmërimi (paraqitja) e sëmundjeve etj.

Me derdhjen e freonit (amoniakut) i cili gjendet në komoren ftohse që nevojitet për ftohjen e mishit. Të gjitha ndikimet aksidentale të lartë cekura janë afatshkurta dhe me ndikime të vogla në mjedis.

7.8. Ndikimet në raste të përfundimit të aktivitetit të thertoresh

Aktiviteti i thertoresh për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët ekonomikisht planifikohet në afat mbi dhjetë vite, ku pasandaj do të shiqohet në bazë të leverdis ekonomike dhe kushteve të tregut se a do të vazhdohet me veprimtari të njëjtë apo objektet do të shfrytëzohen për ndonjë aktivitet tjetër, ose do të përfundohet me këtë aktivitet prodhues dhe objektet me infrastrukturë përcjellëse do të largohen nga lokacioni. Gjatë largimit të objekteve me infrastrukturë përcjellëse ndikimet negative në mjedis janë të njëjta sikurse gjatë ndërtimit të objekteve me infrastrukturë përcjellëse të thertoresh për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët.

7.9.. Marrja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në mjedis dhe atë në ajër, tokë, ujë si dhe në ruajtjen e shëndetit të njeriut, gjatë fazës së ndërtimit të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët, gjatë fazës së kryerjes të aktiviteteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët si dhe gjatë fazës së përfundimit të aktiviteteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët, duhet të merren masat që do të shkruhen në vijim:

7.10.. Masat për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës së ndërtimit të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët duhet të merren këto masa: Gjatë punës me makina ngarkuese dhe transportuese të gjitha sipërfaqet manipuluese të stërpikën me ujë posaçërisht në kohra me erëra dhe temperatura të larta. Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ. Sipërfaqet manipuluese të spërkatën me ujë.

Gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët, me qëllim të zvogëlimin të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si produkt i aromës së keqe që lirohet nga plehrat, aroma e keqe nga plehrat lirohet vetëm gjatë ngarkimit dhe transportit të plehrave, nëse plehrat qëndrojnë për një kohë më të gjatë në hapësirë të hapur në oborrin e fermës, plehrat duhet të mbulohen (të mbrohen nga era) në mënyrë që përhapja e aromës së pakëndshme të zvogëlohet në maksimum. Aroma e pakëndshme nga objektet e thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët bëhet mbjelljen e murit të gjallë nga bimët dekoruesve rreth e përqark objekteve të thertores në naltësi dy deri në dy e gjysmë metra, muri i gjallë e pengon shpërndarjen e aromës së pakëndshme në hapësirën jashtë objekteve të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët.

Duhet të bëhet ventilimi i hapësirave prodhuese, prandaj në njërin anë të murit do të vendosën ventilatorët me biofiltër për pastrimin e ajrit, kurse në anën tjetër të murit do të vendosen hapjet për hyrjen e sasisë së ajrit të pastër aq sa është nxjerrur me anë të ventilatorëve, gjithashtu aroma e pakëndshme do të zvogëlohet përmes ajrimit artificial përmes dritareve të shumta të vendosura në objekt, me qëllim të zvogëlimin të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si produkt i djegies së lëndëve djegëse për therjen e mishit, suxhukut, ngrohjen e hapësirave gjatë stinës së dimrit është e nevojshme të sigurohen kushtet për djegie sa më kualitative. Prandaj nëse përpjesëtimi i ajrit dhe lëndës djegëse është optimal atëherë në atmosferë lirohen gazrat me ndotës në sasi më të vogël.

Objekti duhet të pajisen me termoizolim në pajtim me kushtet klimatike dhe zonën klimatike, në mënyrë që gjatë stinës së dimrit të harxhohet sa më pak energji për ngrohje e gjatë stinës së verës të harxhohet sa më pak energji për ftohje. Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet transportuese të gjedheve, ushqimit të gjedheve të mishit dhe transportit të plehut të jetë sa më kualitativ.

7.11. Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë, gjatë fazës së ndërtimit të thertores për therjen e gjedheve dhe përpunimit të mishit të freskët duhet të merren këto masa: Dheu i deponuar duhet të shfrytëzohet për rrafshimin, planifikimin e terenit i cili duhet të mbillet, pjesa tjetër e dheut duhet të dërgohet në deponin e qytetit, të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore duhet të klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, dhe të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren dhe shitën për nevoja komerciale duhet të dërgohen në deponin e qytetit.

